



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:278836

Datë: 17.11.2022

Numri i dokumentit: 03658582

P.nr.76/2020

### NË EMËR TË POPULLIT

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdijaj, bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu dhe procesmbajtësen Florije Gucati, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit I., Sh., nga fshatin ....Komuna Skenderaj, me adresë vendbanimi në ..., për shkak të veprës penale-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.3252/2018 të datës 11.03.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datë 03.11.2022, në të cilën prezent ishin prokurorja e shtetit Stojanka Kasaloviq, i pandehuri I., Sh., si dhe përkthyesi i gjykatës Shaban Hajra, më datën 03.11.2022 e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa më datën 17.11.2021, e përpiloi këtë :

### A K T G J Y K I M

- I pandehuri I., Sh., nga babai „dhe nëna ., mbiemri i vajzërisë ..., i lindur me datë (data e lindjes) në fshatin ...Komuna Skenderaj, tani jeton në ..., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer Shkollën e Mesme, i martuar... fëmijëve, i punësuar në ....-punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike.

### - Ë S H T Ë F A J T O R -

- **SEPSE** : Në fillim të muajit Shkurt 2018 në Skenderaj, nga personi .., fshati ... ka siguruar Certifikatën e Veteranit të luftës të regjistruar nën numrin ... të datës ..., si dhe Vërtetimin e zyrës për çështje të personave të dalë nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në emrin e tij me nr.44347/2018, të datës 13.02.2018, edhe pse i njëjti nuk ka qenë ushtar i rregullt dhe nuk gjendej në listën e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ashtu që dokumentacioni e tillë me kërkesën për pensionin e veteranit nr.02 05 4059 e ka dorëzuar me datë 26.02.2018 në Zyrën e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie sociale - Departamenti i

Familjeve të Dëshmoreve dhe invalidëve të Luftës në Mitrovicë, pra ka përdorur dokumentin e rrejshëm publik si të vërtetë.

**- Me këtë ka kryer veprën penale-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore dhe neneve : 4, 41, 46, 69, 73 dhe 74 të KPRK-së, e lidhur me nenet 450 par.2 nënpar.2.6, 453 par.1 si dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin:

### **- E G J Y K O N -**

**I.- Me dënim me gjobë** në shumën prej **gjashtëqind (600.00) euro**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditëve prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**II.-** Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

**III.-** Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20.00 € (njëzetë euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**IV.-** Gjkata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 69 par.1 të KPRK-së, krahas dënimit kryesor shqipton dhe :

#### **DËNIM PLOTËSUES-Marrja e sendit**

**URDHËROHET** konfiskimi i përhershëm i Certifikatës Nr.L4/7601 të datës 26.04.2016 dhe Vërtetimin Nr.44347/2018 të datës 13.02.2018, i Zyrës për çështje të kategorive të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

**V. -** Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk kishte, andaj për kërkesën pasurore-juridike, gjykata nuk vendosi fare në procedurë penale.

### **- A r s y e t i m -**

#### **- Rrjedha e çështjes -**

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP-II.nr.3252/2018 të datës 11.03.2020, ndaj të pandehurit I., Sh., nga fshatin ....-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

- Gjykata në këtë çështje penale më datë 03.11.2022 e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, e cila ka qenë e hapur për publikun, ndërsa ishin prezent prokurorja e shtetit Stojanka Kasaloviq, i pandehuri I., Sh., si dhe përkthyesi i gjykatës ..., ashtu që të pandehurin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij ndërsa, sa i përket mbrojtjes ka deklaruar se në këtë çështje penale dëshiron të mbrohet vet.

#### **- Vlerësimi i pranimi të fajësisë -**

- Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, gjykata të pandehurin e ka njoftuar hollësisht me pasojat e pranimi të fajësisë, i njëjti ka deklaruar se, i ka kuptuar pasojat e pranimi të fajësisë e më pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, njëherësh shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do t'i përsërisë veprimet e tilla njëheritë, nëse gjykata me shpall fajtor atëherë i propozoj që të dënojë me një dënim sa më të butë, ashtu që lidhur me veprimet e tij është penduar thellësisht, duke theksuar më tej që gjykata të ketë parasysh faktin se që 11 vite jeton në Gjermani me familjen e tij, punonë dhe deri me tani asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin.

- Pas pranimi të fajësisë nga i pandehuri, gjykata e kërkojë mendimin nga prokurorja e shtetit, e cila me këtë rast deklaroi se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa imponime, ky pranim i fajësisë ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe i propozoi gjykatës që ta aprovoj këtë pranimi fajësie.

- Pas pranimi të fajësisë nga i pandehuri, marrjes së mendimit nga prokurorja e shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të dispozitës ligjore nga neni 248 par.4 lidhur me par.1 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze ngase, konsideroi se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimi të fajësisë, i cili pranim është mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde, dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

#### **- Gjendja faktike e vërtetuar -**

- Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para se gjithash nga pranimi i fajësisë nga i pandehuri, pranim i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës në raport me të pandehurin, siç ishin : Procesverbalin mbi marrje në pyetje të dëshmitarit-...Nr.2018-DKR-58 të datës 16.05.2018, lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor Mitrovicë Jug, Certifikatën në emër të të pandehurit Nr.L4/7601 të datës 26.04.2016,

Vërtetimin nga zyra për çështjet e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së Nr.44347/2018 të datës 13.02.2018, Kërkesën – Formulari për aplikim në emër të të pandehurit për pension të veteranëve Nr.02 05 4059 të datës 26.02.2018, Kontrata mbi hapjen e llogarisë rrjedhëse për persona fizik të datës 22.02.2018 lëshuar nga NLB Banka, Qarkullimin për llogari të datës 31.01.2020 të lëshuar nga NLB Banka në emër të të pandehurit, Përgjigjen në kërkesën për informata lëshuar nga NLB Banka të datës 31.01.2020, Listën e verifikimit të personave lëshuar nga MPMS-Zyra për Çështje të Kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së të datës 14.05.2018, Vërtetimin mbi sekuestrumin e përkohshëm të sendeve të datës 30.05.2018 të lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor Mitrovicë, Vërtetim Tatimor i datës 20.02.2018 lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës në emër të të akuzuarit, Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile së të pandehurit E ..., lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Skenderaj me datë 21.02.2018, si dhe është bërë vështrim në shkresat tjera të lëndës.

- Në bazë të gjendjes faktike të pakontestueshme, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të pandehurit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale- Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, ngase i njëjti gjatë muajit Shkurt 2018 në Skenderaj, nga personi M., H., nga fshati ... ka siguruar Certifikatën e Veteranit të luftës të regjistruar nën numrin L4/7601 të datës 26.04.2016, si dhe Vërtetimin e zyrës për çështje të personave të dalë nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në emrin e tij me nr.44347/2018, të datës 13.02.2018, edhe pse i njëjti nuk ka qenë ushtar i rregullt dhe nuk gjendej në listën e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ashtu që dokumentacioni e tillë me kërkesën për pensionin e veteranit nr.02 05 4059 e ka dorëzuar me datë 26.02.2018 në Zyrën e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie sociale – Departamenti i Familjeve të Dëshmoreve dhe invalidëve të Luftës në Mitrovicë, pra ka përdorur dokumentin e rrejtshëm publik si të vërtetë, për çka gjykata gjeti se e pandehura në aspektin penal-juridik është përgjegjëse dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **- Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit -**

- Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, gjykata i mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, e në rastin konkret për të pandehurin si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjithashtu, rrethanë tjetër lehtësuese gjykata mori rrethanat e tij personale se i njëjti është familjar, baba i ..., pastaj pendimin e tij të thellë dhe keqardhjen e shfaqur lidhur me rastin që ka ndodhur, si dhe premtimin gjykatës se nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë rënduese në rastin konkret gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes dhe të përgjegjësisë penale të tij.

- Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë ndaj të pandehurit duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike dhe të ardhurat që realizonë meqë i njëjti është në marrëdhënie pune në ....

- Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të pandehurit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### **- Vendimi për shqiptimin e dënimit plotësues -**

- Gjkata vendimin mbi dënimin plotësues-marrjen e sendit, e mori duke u bazuar në nenin 69 par.1 të KPRK-së dhe ka **Urdhëruar** konfiskimin e përhershëm të Certifikatës Nr.L4/7601 të datës 26.04.2016 dhe Vërtetimin Nr.44347/2018 të datës 13.02.2018, që të dy këto dokumente në emër të të pandehurit pasi që, të njëjtat janë përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale, gjithashtu të njëjtat janë rezultat i kryerjes së veprës penale nga i pandehuri, për të cilën u shpallë fajtores dhe iu shqiptua dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike -**

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk kishte, andaj për kërkesën pasurore juridike gjykata nuk vendosi fare në procedurë penale.

- Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ**  
**- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**  
**P.nr.76/2020 me datë 17.11.2021**

**Procesmbajtësja,**  
**Florije Gucati**

---

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Fatos Sejdiqaj**

---

**- KËSHILLË JURIDIKE :** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.